

VENDIM
Nr. 30, datë 18.6.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre’, të ndryshuar”,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinën (prem unl 10 ppm të standardit SSH EN 228 2018), Gazoilin (10 ppm ULSD të standardit SSH EN 590 2018) dhe gazin e lëngshëm të naftës (propan/butan). Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhet bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në) janë çmime tavan/maksimale dhe asnjë operator ekonomik nuk mund t’i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t’i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara në Bord:

a) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë të produkteve, janë si më poshtë:

- 249 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;
- 224 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;
- 74 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës;

b) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me pakicë të produkteve, janë si më poshtë:

- 261 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;
- 236 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;
- 86 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 18.6.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre’, të ndryshuar”.

4. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi